

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : Konsultim publik për buxhetin e vitit 2024.

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë.

Qëllimi: Ky bashkëbisedim me banorët dhe grupet e synuara të interesit dhe ato të marginalizuara të Bashkisë Krujë ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me ndryshimet apo propozimet për ndryshime të projekt buxhetit për vitin 2024.

Sqarime: Konsultimi publik në lidhje me projekt buxhetin e vitit 2024 bazohet mbi të dhënat e raportit të performancës për vitin 2022 si dhe rekomandimet e marra nga pyetësi i zhvilluar on line për tavanet buxhetore 2024-2026.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, godina e Bashkisë Krujë, kati i I-rë, në datë 7/12/2022, ora 11:00.

Gjithashtu, sugjerimet e tyre janë të mirëpritura deri më datë 10 Dhjetor 2023, në adresën e emailit:

gjon1986_jur@live.com

Pjesëmarrës:

- **Nga ana e Bashkisë:** Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, Kryetar/Nënkryetar/Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë, Sekretar i Këshillit Bashkiak, Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, drejtues/punonjës të administratës, drejtoria e buxhetit dhe financës, sektori i tatim taksave, Kryetarët e Fshatrave dhe Administratorët e Njësive Administrative.
- **Nga komuniteti:** Banorët e Bashkisë Krujë, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias, gjimnazet, mësuesit dhe përfaqësues të komunitetit, grupe të ndryshme interesi apo grupet e marginalizuara, etj.

Forma e konsultimit: Takim në terren.

Qëllimi i këshillimit publik	Konsultimi publik në terren synon konsultimin e projekt buxhetit të vitit 2024.
Përshkrimi i çështjes.	Miratimi i draftit projekt buxhetit është një vendim i rëndësishëm që merret nga Këshilli i Bashkisë, pasi përcakton fondet që do të përdoren për të gjitha shërbimet / funksionet e ushtruara nga Bashkia dhe performancën e tyre. Këshilli i Bashkisë duhet të sigurohet që fondet publike shkojnë për përmirësimin e shërbimeve që ofrohen nga Bashkia për komunitetin dhe adresojnë nevojat e tyre, brenda kapaciteteve financuese të Bashkisë. Për këtë, administrata e Bashkisë së bashku me Këshillin e Bashkisë do të organizojnë këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve mbi draftin e buxhetit të vitit 2024.
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresën e emailit të sekretarisë së Këshillit Bashkiak dhe Koordinatorit për Konsultimin me Publikun, BRENDA DATËS 10 Dhjetor 2023. gjon1986_jur@live.com

	Adresa: Këshilli i Bashkisë, Godina e Bashkisë Krujë, kati i I-rë.
Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme	Opsionet e mundëshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit : Ndryshime dhe sugjerime në alokimin e fondeve për programe të caktuara me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Bashkia.
Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, në lidhje me çështjen që konsultohet.	Materialet dhe relacionet për konsultimin me publikun mund t'i gjeni në faqen Web të bashkisë, në link më poshtë: https://kruja.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/RELACION-PBA-2024-2026-BASHKIA-KRUJE.pdf
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmerren Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Dërgimi i sugjerimeve të komunitetit do të jetë i mundur deri në 10 Dhjetor 2023 , nëpërmjet adresës së emailit: gjon1986_jur@live.com Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon: 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje; 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Komisionit të Ekonomisë dhe Financës, taksave dhe tarifave dhe çdo këshilltari të bashkisë; 3. Shqyrtimi nga ana e komisionit të ekonomisë dhe financës, taksave dhe tarifave (mbledhja e komisionit është e hapur për publikun) të cdo rekomandimi dhe dërgimi i tyre tek Kryetari i Bashkisë; 4. Kthimi i përgjigjes dhe rekomandimeve nga ana e Kryetari të Bashkisë. 5. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projekt buxhetin afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor. Vendimi i bashkëngjitet dokumentit të projekt buxhetit vjetor; 6. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit; 7. Informimi i komunitetit, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre; 8. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; 9. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar; 10. Monitorimi i zbatimit të tij.
Data e publikimit	17.11.2023